



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KOMERCIALE**

---

Numri i lëndës: 2023:201281  
Datë: 30.05.2024  
Numri i dokumentit: 05760143

KPPP.nr.1512/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përmbartimore të kreditorit “KBERISHA” SHPK, me seli në Rr.”Hyzri Talla”, Komuna e Prishtinës, me NUI:811151274 të cilin sipas autorizimit e përfaqëson B.K. avokat nga Malisheva, kundër debitorit “ADO CEM” SHPK, me seli në Rahovec Rr. “Xhelal Hajra” pn me NUI:811577701, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.441/23 të datës 14.08.2023 të nxjerrë nga Përmbartuesi Privat Gjokë Radi, me seli në Gjakovë, jashtë seancës me datë 29.05.2024, merr këtë:

**A K T V E N D I M**

I. REFUZOHET NË TËRËSI i pabazuar prapësimi i debitorit “ADO CEM” SHPK, me seli në Rahovec Rr. “Xhelal Hajra” pn me NUI:811577701, i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.441/23 të datës 14.08.2023 të nxjerrë nga Përmbartuesi Privat Gjokë Radi, me seli në Prizren, dhe i njëjti Urdhër mbetet në fuqi në tërësi.

II. Detyrohet debitori t’ia paguaj kreditorit shpenzimet e procedurës në shumë të përgjithshme prej 104 €, në emër të përpilimit të përgjigjes në prapësim nga avokati.

## A r s y e t i m

Përmbaresi Privat, me Urdhrin Përmbarimor P.nr.441/23 të datës 14.08.2023, e ka caktuar përmbarimin ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm – faturës nr.01, shifra 23-SHV01-001-2 të datës 25.05.2023, duke urdhëruar debitorin në emër të borxhit të papaguar ndaj kreditorit, pagesën e borxhit në vlerë prej 25,000.00 Euro, me kamatë ligjore prej 8 % nga kur është dashur të paguhet fatura, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Kundër urdhrin të Përmbaresit Privat, brenda afatit të rregullt ligjor ka ushtruar prapësim debitori, me arsyetimin se propozimi i kreditorit i lejuar me urdhrin e atakuar me këtë prapësim është i pabazuar dhe nuk është i mbështetur në prova, kërkesa ka të bëjë për borxh në bazë të faturës e cila nuk ka tipare të përmbarueshmërisë, po ashtu debitori ka theksuar se nuk ka asnjë dëshmi që debitori ka kryer punë ndërtimore gjithashtu kreditori nuk ka ofruar asnjë libër ndërtimor që të dëshmohet se debitori ka kryer punët ndërtimore. Debitori ka shtuar faktin se kreditori propozimit për përmbarim nuk ia ka bashkangjitur origjinalin apo kopjen e vërtetuar të dokumentit të besueshëm, ashtu siç është përcaktuar me dispozitat ligjore të LPP-së. I ka propozuar gjykatës që të pranohet në tërësi si i bazuar prapësimi i debitorit, ndërsa urdhri për përmbarim i Përmbaresit Privat të anulohet.

Kreditori brenda afatit të rregullt ligjor ka paraqitur përgjigje në prapësim në të cilin ka deklaruar se nuk qëndron konstatimi i debitorit se nuk është bashkangjitur origjinali apo kopja e vërtetuar e dokumentit të besueshëm, për arsye se fatura është e rregullt, origjinale dhe e pranueshme. Ka theksuar se faturat si dokument i besueshëm për përmbarim në këtë çështje i plotësojnë të gjitha kushtet dhe tiparet për të qenë të tillë, për shkak se kreditori faturën e ka lëshuar në mënyrë të rregullt dhe se debitori ka qenë i njoftuar me këtë faturë. Po ashtu kreditori ka pretenduar se prapësimi është bërë vetëm sa për të vonuar lëndën pasi nuk ka bazë për prapësim. I ka propozuar gjykatës që urdhri përmbarimor të mbetet në fuqi, si dhe i ka kërkuar shpenzimet e procedurës në emër të përgjigjes në prapësim, në shumën prej 312.00 Euro, si dhe shpenzimet tjera sipas autorizimit dhe shpenzimet e përmbaresit privat.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve në prapësim të debitorit të përmbartimit, përgjigjes në prapësim të kreditorit, dhe analizimit të shkresave në lëndë, ka gjetur se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe duhet të refuzohet në tërësi nga shkaqet si në vijim:

Në shkresat e lëndës është evidentuar se kreditori i ka bashkëngjitur propozimit për përmbartim dokumentin e besueshëm faturës nr.01, shifra 23-SHV01-001-2 të datës 25.05.2023 në origjinal dhe me të gjitha elementet përmbajtësore të cilat i përcakton LPP me nenin 29 dhe 37.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërkaq me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*; Tutje me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm, sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura nr.5 e datës 12.12.2022, dhe fatura nr.6 e datës 21.12.2022, i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP-së, për zbatimin e përmbartimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që në këto fatura janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturave, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, të njëjtat janë dorëzuar në origjinal dhe janë pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, fakt ky i cili vërtetohet me nënshkrimin dhe vulën e debitorit.

Andaj, bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbartimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së.

Lidhur me shpenzimet procedurale gjykata vendosi në bazë të nenit 452 par. 1 dhe 463 par.1 dhe 2 të LPK-së lidhur me nenin 17 të LPP-së. Gjykata e gjeti si të bazuar kërkesën e kreditorit për pagesë të shpenzimeve sa i përket përpilimit të përgjigjes në prapësim, ndërsa

lartësinë e saj gjykata e llogariti duke u bazuar në Rregulloren për Tarifën e Odës së Avokatëve të nxjerrë nga Oda e Avokatëve më 18 mars 2017, siç përcakton neni 453 para. 2 LPK-së lidhur me nenin 13 dhe 17 të LPP-së, ashtu që si bazë u mor lartësia e vlerës së përmbartimit, numri i palëve të përfaqësuar, si dhe lloji i veprimit procedural për të cilin janë kërkuar shpenzimet.

Meqenëse në këtë çështje përmbartimore gjykata vlerëson përshtatshmërinë e dokumentit përmbartues sipas dispozitave të zbatuara ligjore, nga sa u tha më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

### GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1512/23, me datë 29.05.2024

Gj y q t a r i  
Alajdin Tërshnjaku

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Dhomën e Shkallës së dytë të Gjykatës Komerciale të Kosovës me seli në Prishtinë.